



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË DYTË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

PROCESVERBALI ËSHTË I PA LEKTURUAR (lektori është ne pushim prindëror)

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më 27.02.2020 (e Enjte) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Naim Pira, kryetari, z.Sokol Haliti, nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu, si dhe këshilltarët e Kuvendit: Basri Sylejmani, Zejnepe Osmani, Valbona Haziri, Ramadan Deliu, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Taibe Ibrahimimi, Zekirja Zuka, Nijazi Isaku, Jakup Demiri, Sejdi Emimi, Mirlinda Sadiku, Liridona Bislimi, Remzi Salihu, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Blerina Lubishtani, Samet Idrizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Valentina Hasani, Vehbi Rama, Rasim Terziqi, Besim Ymeri. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 27 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e dytë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes, nënkryetarin e Komunës, juve të respektuar këshilltar komunal, drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, përfaqësuesit e OSBE-së, mediat elektronike dhe të gjithë të tjerët që janë prezent. Para se të kalojmë te miratimi i rendit të ditës. Para se të kalojmë në pyetjet dhe përgjigjen, ju njoftoj se konfirmimin e akteve të nxerrura nga Kuvendi Komunal i Vitisë, Zyra Ligjore e MAPL-së, e kemi marr kësaj here naj kanë rikthyer një rregullore për transparenten ti harmonizojmë disa nene të kësaj rregullore, ju njoftoj që afati i fundit për deklarimi e pasurisë është fundi i marsit sekretaria e kuvendit po ju përcjell formularët që ti plotësoni dhe ti dorëzoni, tani fjala është për ju, urdhëroni.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Pershendetje të nderuar të pranishëm, une e niva veten obligatin pershkak të këshilltarit i cili ne dy seanca e shtron qështjen e prurjes së rregullores per rregullimin e orarit të punëve të bizneseve dhe drejtori i drejtoris së inspeksionit e ka qu në zyrën ligjore dhe nga zyra ligjore kam marr propozimin mundësish të shtyhet mos të sjellën në kete seance pershkak se i ka dilemat e veta sa i perkete aspektit ligjor ne hyrje të rregullores aty ku eshte baza ligjore në preambul prandaj unë e kam miratu propozimin e zyrës ligjore e ndiva veten obligativ që të ju njoftoj tani ne fillim që mos të na perseritet vazhdimish ajo pyetje.

z.Ali Bajrami: Pershendetej të nderuar të pranishëm, unë per kete seanc i kam dy pyetje dhe një njoftim ose informat, informatën e kërkoj prej zv drejtoreshës sa i perkete një epidemie që eshte tasht koronavirusi ta sjell një njoftim per masat që i ka marr QKMF-ja në nivel të komunes së Vitise, pyetje tjeer e kame per kryetarin e komitetit per arsim, kultur, rinis, sport, të na njofton per vizitat që i kan bë në dy shkolla per gjendjen në shkolla që i kan vizitu dhe pyetja tjeter eshte urdhëresa që eshte inicu prej kryetarit per futjen në sistem të mbeturinave të fshatrave dhe qytetit të vitise që eshte mase e nevojshme.

z.Nuredin Lutfiu: Pershendete të nderuar të pranishëm, si që jemi të njoftuar një pjesë e bizneseve e shkelin të drejtat e punëtorve kame një pyetje për drejtorin e inspektoratit a ka prej inspektorve të cilët dalin në terren për të kontrolluar bizneset të mirren me kontratat e punëtorve, orarin e punëtorve dhe deklarimin e tyre, dhe pyetja e dytë është për drejtoreshën e katastrofit lidhur me pronat e AKP-së kemi bërë disa përkesa disa propozim vendime në kuvendin komunal për të cilat të kalojnë në prone publike me interes të veçantë me intereson ta di ku është kjo procedure.

z.Idajete Pira: Pershendetje të nderuar të pranishëm une du të ju drejtohem me dy kërkesa që lidhen me sektorin e shëndetësisë konkretisht me QMF në Pozharan, ne e kemi një hapësirë të madhe të objektit të QMF-së e cila ka kohë që nuk ka mirëmbajtës gjithashtu edhe pse një objekt kaq i madh kemi vetëm dy pastrues që bëjnë pastrimin e objektit dhe është e pamundur që të mbahet pastërtia në nivel të duhur QMF-ja në Pozharan punon 24 orë prandaj është e domosdoshëm të shtohet edhe një pastrues në mënyrë që mos kemi problem ku dihet që primare në shëndetësi është pastërtia pa pastërti nuk ka shëndet gjithashtu pres që shpejt të sigurohet edhe një mirëmbajtës i oborrit pasi që në krejt QKMF- të në Viti ka vetëm një mirëmbajtës ku është e pamundur të mirëmbajt 13 objekte shëndetësore po kërkoj që të behet zgjidhje e shpejt me kontrata me vepër sepse unë kame biseduar disa herë me drejtoreshën për këtë çështje po është e pamundshme të realizohet me kontratë të rregullt pasi që nuk e lejon ministria e financave të shtohet vende të punës.

z.Remzi Salihu: Pershendete të nderuar të pranishëm unë është fjala për disa projekte që do të përmesndi me radhë, asfaltimi i rrugës Ballanc-Terpez, asfaltimi i rrugës në fsh.Gushice, asfaltimi i rrugës Viti-Mogille, rregullimi i fushës së futbollit Viti e Pozharan, rregullimi i palestrës sportive në Drobesh në të gjitha këto dyshohet se ka parregullsi mirë po një prej tyre unë e kame veqaurë asfaltimi i rrugës Ballanc-Terpez pyetje për drejtorin e financave lidhur me këtë projekt të viti 2016 kur dihet që ky projekt është i bashkefinancuar nga ministria përkatëse dhe komuna aty komuna ka participuar me 22 mijë euro dhe këto 22 mijë euro janë kthyer në fund të viti 2019 më 31.12.2019 nga kompania KEMA COMPANY drejtor a mundesh me një shpjegim se si ka ndodhur kjo dhe pse pas tri viteve është bërë ndonjë lëshim, pastaj për përmbaruesin privat si është e mundshme që përmbaruesi privat Kushtrim Musa të marrë komunes 84 mijë e 235 euro e 86 cent i kame këto shifra e ndarura psh 11 mijë e 700, tjetra 7200, tjetra 48 mijë, 16 mijë po në total 84 mijë pse janë dash të mirren këto veprime dhe pse këto pagesa nuk janë bërë në mënyrë të rregullt që mos të ipen parë shtesë nga buxheti i komunes a po nga taksa paguesit e komunes, kame edhe një informat tjetër që me sa më duket është e sakt po më gjithat nuk janë i 100% po pyes se kam dëgjuar se prokuroria ka paditur kompanin Ylli Dekor dhe komunes për një faturë fiktive prej 50 mijë euro a është kjo e vërtetë a po si qëndron puna se vërtetë këtu janë mbledhur shumë gjera dhe dikujt do të plas bomba në dorë për këtë nuk kam dyshim ama se kujt do të plas do ta shohim shumë frikë, dhe për keq përdorimet në komunë e Vitise është e informuar edhe hetuesia në Gjilan por disa ata më pahir a po pa pahiri po vizitojnë të ndërmarrin veprime sepse dikushë punëson grunë e dikujt e dikushë punëson rejen e dikujt kështu që duhet mu kthyer borgji, ka keq përdorime edhe të mjetet e informimit po flas për mjetet e informimit janë paguara për ta rritur imazhin e kryetarit dhe në këtë formë kryetari është perkujtesur shumë mirë të tilla janë zëri, bota sotm telegrami, rajani pres, lajmi, Gjilani info, kosova e lirë kështu që më një fjalë po e përmbylli këtë të keni kujdes edhe kryetari edhe drejtori i financave të mi jep sqarimet në këtë seancë ose nëse nuk ka mundësi në këtë seancë në seancën tjetër.

Znj.Xhilsime Qamili: Përsëndetje të nderuar të pranishëm, unë kame pyetje për drejtorin e inspeksionit gjatë vitit të kaluar keni asgjësuar sasi të madhe të artikujve ushqimorë qëfar mallra keni asgjësuar dhe mënyrë se si i keni asgjësuar ato produkte fjalën e kame për produktet të cilat do të rrezikonin jetën dhe shëndetin e konsumatorve, pyetjen tjetër e kam ju si drejtor a keni rekomanduar për gjendjen se ujërave napershkolat tona dhe a është ndërmarrë ndonjë masë preventive që të permisohet situatat e ujërave të pishem naper shkolla.

znj.Mirlinda Sadiku: Pershendetë të nderuar të pranishëm shume keq që nuk e kemi drejtorin e arsimit tani prezent, ne kemi dhen edhe rekomandimet e tona tek raporti i kryetarit per drejtoreshë ne bujqesis shtëpizat e drunit që i keni ketu e keni shiringën ato shtëpi nuk jan në funksion jane vendos kogjo moti as një her nuk jan funksionalizuar ato kan qen të parapamë per bizneset per treg ditore mire po qka po ndodhe me procedurat kemi pa një foto lajm me kryetarin me shoqatat e grave mire po perderi sa jan në kete gjendje krijohet hapësir per keq përdorim të tyre dhe po ashtu kryerjen e veprave të ndryshme kam kerkese po ashtu nga qytetaret rrugës Safet Rexhepi në Viti eshte një shtyll elektrike e cila paraqet rrezik per qytetaret dhe eshte mir të intervenohet në të.

z.Bekim Azizi: Pershendetej të nderuar të pranishëm, isha lidh tek reagimet e ëep faqes së komunes që i ka bë zyra e informimit nese nuk e ka bë le të thot që nuk e kan bë keta, reagim per drekat zyrtare lidhur me shkrimet e Partis Demokratike jane tendecioze që dezinformojn publikun keto dreka thot të gjitha janë per manifestime të ndryshme per ditën e dëshmorve, datat e caktuara historike, fkaladaku u karadaku dhe kur e marrmi dokumentin e shofm tek drekat zyrtare thot per manifestime 600 euro per 17 Shkurt, per Flakadan të Karadaku i ki 7000 euro per ngritjen e shtatores Bafti Haxhiu 120 euro dreka zyrtare dhe per ditën e shkollës Safet Rexhepi në Zhiti 240 euro as një tjetër drek nuk lidhet me ditën e dëshmorve jane edhe 14 Qershori 1300 dhe të gjitha tjera prej 32 mije euro dikune 25 mije euro jane të tjera dhe thuhet atje që në të gjitha keto dreka kan qen përfaqësuesit e partive politike dhe keshilltaret komunal pa dallim as nje her ne as një drek prej vitin 2019 nuk kan qen as një përfaqësues i partis demokratike të kosoves as keshilltaret komunal as unë si kryetari i partisë dmth kete komunikat kush e ka shkru ne ëep faqe të komunes ka rrejt nese e ka shkru zyra e informimit e ka rrejt qytetarin sepse keto dreka as nuk jan per ditët e dëshmorve, per dreka zyrtare ja bëj nje pyetje drejtorit per shërbime publike komisioni per grumbullimin e ndimave në Shqiperi tek Restaurant Lindi 195 euro ti drejtori je kan kryetar komisioni unë jame anëtar i këtij komisioni unë nuk e di që qaj komision ka hanger drek as një her unë si anëtar i këtij komisioni as që kam qen i njoftuar per kete drek, tek pagesa gjyqësore pyetje per drejtorin e financave nese ki informat sot bën, furnizim me ushqim dhe pije shkolla Safet Rexhepi 2211 euro qfar furnizimi me pije dhe ushqim shkolla fillore që e ka marr gjykata kur e dim që shkollat nuk kan furnizim me pije e ushqime e veqanarisht një shkollë e vogël si që eshte shkolla Safet Rexhepi, një perfaqesues i një kompanie Em Projekt në vitin 2015-2016-2017 në marrveshje po pa të shkru me kryetarin e komunes ka pastru Lumin Morava prej Binqës deri në Budrik dhe vlera e punëve të kryera që i ka me fotografi ku shifen edhe drejtorat që jan aty e punët që jan bë ai thot që puna që eshte bë eshte mbi 100 mije euro obligim që i kane mbete ati mire po kontrat nuk kan bë dhe të gjith bagerat ja kan marr borgjëlit që i ka pas dhe 48 mije euro thot i kame baz deklarimit të ati dajal i cili e ka emri Rafet se kurr nuk e kisha njoft ai thot që 48 mije euro i ka borgj vetëm naft qka ka marr në pomp të benzinit që ka punu me bagera ai as një cent nuk i kish marr per punene që e ka bë bile me tregoj edhe per një pune që e ka qu drejtori i shërbimeve publike në Gushicë me punu po ai ja kish dhën naftin i kish than nese do edhe 100 euro ti jap të mijat ndersa mbi 100 mije euro të gjitha bagerat të gjith at potencial që e ka pas i ka humb dhe qat gjendje e kan qite sa eshte e vërtet kjo e nese nuk e dini ju unë kete informat e kame marr nga personi që e ceka në larte.

z. Taulant Haxhiu: Une prap deshta me kerku per rregullore që rregullon orarin e punës se bizneseve të cilën e kam kërkuar une mire po nënkryetari tha që ne seancën e radhe do ta sjellim, kame një pyetje pre z.Ibrahim Ramiqi eshte e treta seanc që unë e kërkoi një informat per investimet që jan bë në shtepin e kulturës dhe besoj që sot ma ka sjell informatën kame kerku edhe per urën unë afër shtat muaj kam dyshu si shume të tjer se vlera 219 mije euro që jan investu në at ure të shkollat e mesme po doket shume e madhe e enorme unë e kam qujt si investim si të jet ur e San Franciskos kështu që eshte e gjashta her që kam kerku një informat me decitive kurse z.Ramiqi as një her nuk ma ka sjell në kuvend, kam edhe një pyetje per drejtorin z.Nexhmedini tek tregu i gjelbert në Viti ke me nje vizit gjendja ish katastrofale as kushte elementare të punës nuk kish ai treg që e pash unë eshte mir të intervenohet që tregtaret që punojn në tregun e gjelbert të ju ofrohen kushte me të mira të punës.

z.Nijazi Isaku: Përshëndetëj të nderuar të pranishëm, kame një pyetje per drejtorin e financave me qen se edhe u cek me herët që prokuria ka ngrit një rast per faturat fiktive unë e kame edhe një shqetësim që ku e kame një fatur sa eshte e vërtet drejtor une po e bej si pyetje ja ku e kame nr e faturës 2312-2019/1850 është vlere 571 euro sipas disa informatave kjo fatur ju ka dhën një person me emër të kësaj fature dhe ju i keni bë pagesën pa as një pune që është bë, personi nuk po ja ceku emrin në publik po fatura eshte e Agro Sodovina jane disa pune kjo ka ndodhe me 31.12.2019, nr 2182.

z.Ekrem Abazi: Pershendetje të nderuar të pranishëm si që jemi ne dijani ju edhe unë që në kohen e fundit permese mjeteve të informimit po del sipas opozitës po tham dhe jo sipas demantimit që ju po e bëni që shume projekte në viti që jan kry jane keq perdot me të madhe po i përmendi vetëm dy a tri shtepin e kulturës ku ne jemi tash ketu, shtëpia e bardh e kryetarit te lumi ata far ogjakt që i keni bë po kushton një ogjak 1200 e diqka euro kur po i shikoj kështu nuk po ma merr mendja që ka mujt me ndodh kjo kursesi po po tham sipas opozitës në Viti kur po i qet faktet me fakte sa ka kushtu besoni që edhe unë po besoj po nese kjo eshte e vërtet kjo eshte katasrof per komunene ton dhe per neve si qytetar të kësaj komune dmth ju kisha lut juve kryetari nuk te koka ketu po juve keshilltarve të kryetarit le ta informojn opinionin që nuk jan të vërteta ose jan të vërteta po e përsëris keta opozita në Viti qyshe po thot ju nuk keni lan as një projekt pa keq perdore pa vjedh e keni vjedh paret e qytetarve tone pas kësaj që unë po e shof zyra per informim ka dal një demant po jo bindes apsolut fare nuk eshte bindes e keta opozita po del me shifra po dalin me shënime po opinionin në viti dhe qytetaret e komunes tone po befasohen me hajdukni që jeni tu i bë këtij bugjet kaq të vogël të komunes sonte e ju po i keq përdorni mendoj që dikush duhet me shku në përgjegjësi prej kryetari e bashkepunetoret e tij ata që keq përdorin kete pare të qytetarve, është marre me i qit shifrat 200 mije euro e mos me punu kurgja nese eshte rren sipas opozite at her le ta bajn përgjegjësin keta ju kisha lut po e përsërisë që mos të bëhemi hor se edhe komunat tjera na shofim, se na e dim krey se kush sa pasoni ka pas e kush sa e ka njani me tha jan prokuroret e gjykatat po edhe na e dim bre krey se kush sa pasoni ka pas dhe e sa i ka sot ka i hin ato burime të paras, po po ju lus demantone me fakte opozitën po kam deshir mos mu kan e vërtet kjo qka po thot opozita e Vitise.

z.Sejdi Emimi: Pershendete të nderuar të pranishëm, kryesues është mirë me i sjell mikrofonat se ndoshta ka me shku mandati pa i sjell sepse aty ne mes ku jemi të ulur ne bukur po kemi problem, kam një kerkese që e kam bë edhe mandatin e kaluar që mendoj që eshte kerkes e nevojshme per banoret dhe qytetaret e komunes sonte hapjen e një shkolle të muzikës ku mendoj që tash vetëm edhe ambientin lokalet i kemi të komuna ku po lirohen vendet pasi që kuadrin e kemi kemi kuadër profesional të mjaftueshëm kemi femij talenta ku femit po detyrohen me qu naper komuna të tjera për me i avanca pyetjen ja kisha bë drejtori po nuk te koka ketu e kam bë edhe mandatin e kaluar kjo krekës vazhdon edhe te drejtori i ri, pyetja e dyte ka të bej me drejtorin e sinskesionit nganje her pajtohem kur nuk mundesh me i shty senet ku nuk i ki me ligje mire po ndalimin e pirjes së duhanit nënambiente të mbyllura e ki ligji përpara unë mendoj që është kërkes edhe navoj emergjente per mu ndalu duheni në ambiente të mbyllura pershume arsyeje si e para shëndeti, gjepi drejto kete pune ka me qu deri në fund pergjigjerjen për këtë pyetje nuk ta kërkoj sot e kërkoj në seancën e radhës me tha që po e kemi ndalu, pajtoj plotësash që nuk po mundesh me i largu qenet endacak ama me ndalu duhanin kete mundesh nuk ki arsyeje edhe kur ti hish duheshe me i hi mar jo një lokali po e njërit jo e dikujt me ja hup punene kërkoj me marr masa urgjente e me krye këtë pune, është një kërkesë të cilën e kam bërë shumë herë do ta bëjë edhe sot nëpër disa mjete të informimit pash se mund të pezullohen edhe kyqja jonë në Gerlicë edhe në Ferizaj pasi që e kam kërkuar ma herët po dua me qenë fer me kërkuar edhe sot edhe pse jemi në qeveri por un mendoj se banoret e komunës sonë e gëzojnë këtë të drejtë sa keni informacione e keni ministrin e juaj në infrastrukturë dua me na i dhënë një njoftim të drejtë para qytetareve dhe mos me na u shty kjo far pune se u bë si prrall me tupan, e kam edhe një pyetje për auto ambulancën në Pozheran në seancën e kaluar a ka shkua kjo auto ambulancë a qka ka ndodh me

të, ambulanca e Gushicës nese nuk keni mundësi bile lëshona rrugën ta bëjmë vet ajo nuk ka nevojë me u hutuar për 100 vite hetohet për 6 muaj edhe në rregull është tash ajo ka mbet një gërmadhë aty.

z. Samet Idrizi: në portale lokale po qarkullojnë do informata se projektet që po zhvillohen në komunën e Vitisë nuk po realizohen tërësisht qka është ma e keqja edhe në sasi un nuk kam mund me qëndruar indiferent sidomos ndaj një projekti që është zhvilluar në vitin 2017 te rruga Dëshmoret e Kombit dhe te rruga Ilvi Demiri aty pash se disa shtylla metalike të ndriçimit nuk janë vendosur edhe nuk është bërë ndriçimi publik në rrugën Ilvi Demiri kam pyetje konkrete a kanë qenë në paramas të këtij projekti me u bë ndriçimi në këtë rrugë edhe a kanë qenë në paramas shtyllat elektrike.

Znj. Liridona Bislimi: un kam një shqetësim rreth ndriçimit publik që është bërë në komunën tonë me disa ekspert të elektro teknikës supozohet se disa pjesë të ndriçimit publik si në qytet ashtu edhe në fshatra nuk kanë tokëzim andaj me këtë rast fëmijët janë jarzakonisht të rrezikuar si shembull konkret nëse mund të fokusoheni e kemi këtu një kablo që është në qendër të qytetit të Vitisë pra ky kablo nuk është i lejuar që të përdoret në ambientet taksorë pra është kablo ajror, me intereson gjithashtu edhe rrethe tregut të kafshëve në fshatin Drobesh drejtor pse qytetaret janë të detyruar ta përdorin ende atë lokacion që është afër rrugës kryesore kur e dim se tash e disa vite është i ndare lokacioni janë bërë rrethojat dhe ata vend tash e kanë mbuluar barërat dhe nuk është funksional , gjithashtu edhe në shkolla keni mungesë me produkte higjienike sa keni bërë që kohën e fundit ta ndryshoni këtë situatë duke marr parasysh që kemi nevoja jarzakonisht të mëdha që fëmijët ti përdorin produktet higjienike për shkak të veruesit të famshëm i cili është rrezik edhe në shtetet fqinje , gjithashtu kam një pyetje se a do të bëhet këtë vit dezinfektimi në shkollat e Vitisë ku vit pas viti është paraparë me plan të prokurimit por në praktikë asnjëherë nuk ka dal në funksion , pyetja e fundit është rrethe konkursit plotësues i cili është shfaqur në veb faqen e komunës së Vitisë vetëm për një ditë dhe në këtë konkurs kanë shkruar se 7 ditë kanë drejtë qytetaret që të aplikojnë por pas datës 24,02,2020 është larguar nga EEB faqja e komunës pra qytetaret të cilët kanë qenë të interesuar rrethe këtij konkursi kanë nevojë ta dinë se për qka ka dal ky konkurs vetëm një ditë dhe pastaj është tërheq.

Kryesuesi z.Naim Pira: pasi nuk ka tjerë për diskutim ja kisha kaluar fjalën nënkryetarit

Nënkryetari z. Hasan Aliu: un sot nuk do të ju marr shumë kohë sepse shumica e pyetjeve janë të drejtuara drejtoreve por jo rastësisht ka shanca e kaluar do ti keni zyrat gjeqse për punën të cilët janë të ngarkuar jo në shenjë të mbrojtjes por në shenjë të punës se gjithsecili është përgjegjës për punën e vet që e kryen edhe para ligjit edhe para qytetareve prandaj sot këtu me ne përveç drejtoreve dhe unë është edhe zyra e prokurimit janë edhe menagjeret e projekteve dhe për qdo detaj do ta merrni informacionin e plot ashtu si kërkohet për shkak se në kuvend dhe nëpërmjet mjeteve apo rrjeteve sociale janë dëgjuar shumë sende, un do të ndalem vetëm te ato që konsideroj që nuk janë se sot kemi mungesë të dy drejtoreve një që e përmendi edhe kryesuesi dhe një të shëndetësisë për shkak se ju keni qenë në rrjedhë dhe të ndryshimeve që janë bërë që se shpejti do të caktohet edhe drejtori i shëndetësisë , doktoresha besoj se është në rrjedhë qështja e stafit është shumë problematike për shkak të pengesave të cilave i kemi edhe në ministri të financave e kemi edhe udhëheqësin e personelit që do ta keni një informacion mund edhe ti bëni pyetje në lidhje me të por e di se un e kontaktoj për qdo dit dhe kam informacion se deri me 31 mars edhe me pas të lejuar dhe vend të zbrazet janë të ngrira momentalisht nuk mund me marr punëtor, Sejdi skan ndryshuar tre kryeministra un vazhdoj me besua kemi kemi me bë kam informacion jo të saktë sipas portaleve se ka me u shqyrtuar edhe ajo qysh janë shqyrtuar edhe qështja e projektit të autostradës për Gjilan për shkak se nuk është kontestuese mos me u kyç por është kontestuese shumë dhe po konsiderojnë që kanë bërë mos përfillje të proceduarave se përndryshe qështja për me u kyç jam me ty gjithherë por nëse është për rregullim të aspektit ligjor jam për me prit edhe ndonjë dit dhe krejt në fund tash do ti keni drejtoret që do të përgjigjen , qështja e ambulantes që e ngrite na nuk e kemi penguar kurrë Gushicën që me marr iniciativa se pengoj asnjë qytetar , ishte një shqetësim i këshilltares se tha një konkurs e kemi pas ndërrimin e

drejtorit dhe pikërisht drejtori i ri e ka pa të arsyeshme me ndal për momentin deri sa të njoftohet me problematiken dhe besoj se e lëshon konkursin nuk është problem dhe qështja e tregut të kafshëve e di që ja bëre drejtorit po jam në rrjedha edhe unë jemi duke e shikuar mundësin deri tash funksionalizimi i tregjeve nuk na ka shkuar mirë jo që nuk kemi dashur ne si komunë po ndoshta me gjete një formë me qit në ankand dhe me ja dhanë njerëzve të specializuar rrethe asaj qështje e din problemin e higjienën me tregun e gjelbër dhe nuk po dojmë tash edhe tregun e kafshëve me qenë e asaj forme un besoj se së shpejti do ta sjellim në kuvend për me qit në ankand publik dhe do ti funksionalizojmë ,Mirlinda plotësisht ishte një pyetje me vend rrethe atyre barakave ne e kemi shqyrtuar mundësin qa mundemi me bërë dhe e kemi par se forma ma e mirë e mundshme është të ju japim shoqatave ato ti ekspozojnë produktet e veta ato kanë një kontratë që do të paguajnë 12 euro në vit që shërbimet e ujit dhe të rrymës me i paguar komuna.

Znj.Majlinda Ostrogllava: un pata një pyetje nga asamblistin z. Nuredin Lutfiu qka ka ndodh me pronat e komunës të cilat janë në AKP – kërkesat kanë qenë të vazhdueshme edhe nga drejtoresha Fatbardha por edhe nga unë por për shkak të disa problemeve ligjore u pezullua vendimi në kushtetuese qdo njoftim qa na vjen i ri ne do të ju njoftojmë me kohë .

Znj: Gjylsime Qamili; un nuk do të hy ne detale me përshkruar informatën si ka rrjedh sëmundja e korona veruesit mirëpo në pika të shkurtra do ta falënderoj së pari institutin kombëtar të shëndetit publik i cili del me informata të rregullta dhe dashtë fati që Kosova nuk është e përfshirë me këtë sëmundje, ne kemi bërë përgatitje në QKMF në krye me drejtoreshën e cila është për tu falënderuar për përgatitjet kemi formuar epiken komunale për korona verues ku hynë epidemiologu mjeku familjar mjeku i përgjithshëm infermieri inspektori sanitar veterinari i zyrave dhe zyra për informim, kemi formuar ekipet kujdestare një mjek dy infermier të gatshëm 24orë të japin kontributin e tyre kemi shpërndare posteret në ambulantë dhe sot neper shkolla kemi mbajtur kontrolla të vazhdueshme me institutin kombëtar të shëndetit publik sa i përket pajisjeve ende nuk jemi të pajisur me këto pajisje mirëpo në vazhdimësi doktoresha mban kontakt me institutet përkatëse dhe së shpejti do të pajisemi sa i përket maskave e gjerave tjera jemi të pajisur mirëpo qka është me rëndësi edhe informimi i bollshëm është bërë .

Znj.Hidajete Pira: sa i përket këtij virusi shumë është e vërtet se drejtoresha ka kontribuar në këtë aspekt duke mbajtur ligjërata janë të informuar edhe stafi mjekësor por sa i përket furnizimit këto maska që janë tash qa i përdorim janë shumë të thjeshta dhe smunden me i rezistuar ato janë maska tjera që mund me ndalu korona virusin ato kushtojnë 15 euro një maskë un mendoj se duhet me marr masa edhe me u furnizuar me to se sa i përket këtyre maskave qa i kemi këto nuk munden me na mbrojt .

z.Ibrahim Rama; disa pyetje ju adresuan drejtorisë për financa që kanë të bëjnë me punën dhe problematiken e investimeve kapitale të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe , një pyetje ishte për asfaltimin e rrugës Ballanc-Tërpezë që e parashtrroi këshilltari Remzi ka të bëjë me pagesën e këtij projekti fjala është për një projekt të bashkfinancuar ndërmjet ministrisë së infrastrukturës dhe Komunës së Vitisë që një pjesë të pagesës kemi pas na si komunë me bërë si participim ne e kemi kryer në vitin 2017 në vlerë prej 21 mijë euro dhe ndërkohë operatori ekonomik e ka marr një pagesë prej ministrisë përkatëse dhe në fund kur barazohet projekti mirren të gjitha pagesat dhe parëzohen mbyllet projekti konform kontratës që është paraparë dhe në këtë drejtim në fund të vitit2018 kur na i kanë sjell ministrit gjitha shënimet për pagesa që kanë ndodh për këtë projekt punëtori komunal e ka pa që është tejkalluar pagesa për 20 mijë e sa euro tash në këtë rast pasi kemi qenë na bashk financues kena bërë kërkesë na nga operatori ekonomik me na u kthye mjetet për atë që kemi paguar dhe operatori ekonomik na i ka kthye mjetet në fund të vitit 2019, pyetja tjetër ka të bëjë me pagesën e e përmbaruesit privat Kushtrimi MN Musa me ligjet në fuqi kanë drejtë komunat përmes përmbaruesit privat me i inkasua të gjitha obligimet që kanë qytetaret ndaj komunës së Vitisë dhe na këtë të drejtë ligjore e kemi shfrytëzuar ju e dini të gjithë kjo masë ka pas rezultate pra në këtë drejtim barazimi që është bërë ka qenë i mirë na nuk paguajmë asgjë

prej komunës sa i përket kësaj , një pyetje ishte për Ylli Dekor un nuk di nuk kam asnjë informacion skam ndonjë përgjigje nuk jam në njohuri që ka ndonjë padi, pyetja tjetër ishte nga Dekim Azizi një faktur për pije dhe furnizim për shkollën fillore Safet Rexhepi për momentin nuk e di qka përmban kjo fakturë dhe arsyen e pagesës në takimin e radhës mundem me ti dhanë shënimet konkrete për këtë pyetja tjetër pastrimi i lumit Morava dokumentacion edhe ju e ceket se nuk ka , Taulanti një pyetje që ka të bëjë me projektin e renovimit të shtëpisë së Kulturës por fjala është për renovimin e objektit komunës që hynë edhe salla e kuvendit komunal po ju informoj se projekti është në vazhdim e sipër nuk ka pranim për punët që i ka krye në vitin 2019 pagesat të gjithat janë bërë një pjesë e punëve që nuk janë krye ka filluar operatori ekonomik me i krye dhe në fund komisioni i pranimit teknik do ti shikon të gjitha ato vërejtje që janë të parapamë me u përmirësuar , pyetja tjetre për urat i nderuar këshilltar unë javë kam pas dhanë një raport por gjitha dosjet e tenderimit janë në zyre të prokurimit a ato qa na takojnë neve unë ti kam sjell, edhe një pyetje që e parashtror Njazi Iskau që ka të bëjë me fakturen e Agro Sadovina për momentin nuk kam ide por ne takimin e radhës do ta merrni një përgjigje .

z. Nexhmedin Jakupi; ishin nja dy pyetje për drejtorin e shërbimeve publike, Bekimi e bëri një pyetje rrethe një fature që është shpenzuar për dreka kanë qenë dreka zyrtare pasi edhe Beka ka qenë anëtar i komisionit aty nuk është dhënë një drek solemne mirëpo një numër i caktuar i anëtareve të komisionit dhe disa vullnetar që kanë qenë të kryqit të kuq edhe nënës terezë dhe disa anëtar të tjerë 10 ditë kanë kujdestaruar te njësitit i zjarrfikëseve d.m.th. ata kanë punuar nga ora 09:00 deri ora 16:00 për grumbullim prandaj un si drejtor e kam par të arsyeshme që kanë punuar me javë porosit nga një drekë, pyetja tjetër ishte nga z. Ali Bajrami është e vërtetë se kryetari i komunës e ka nxjerr një urdhëresë me të cilën i ka obliguar dhe kjo urdhëresë është e thirrur mbi ligjin për qeverisje lokale që ta gjejmë zgjidhjen për mbeturinat kryetari edhe ka caktuar afat deri me 01.04 2020 që këta ta bajnë zgjidhjen të lidhin kontratë me kompaninë e cila do të shkoj te shtëpia dhe do të javë merr mbeturinat, sa për njoftim na do të fillojmë me shpërndarjen e disa kontejnerëve që i kemi donacion nga GIZI dhe ministria e ambientit dhe planifikimit hapësinore planifikojmë në qytetin e Vitisë Pozheranin dhe Kabashin pastaj fazën tjetër edhe gjitha qytetet tjera, po është një kabull e ndriçimit publik te ura te varrezat ortodokse gjat implementimit të projektit të urës operatori e ka shkaktuar këtë dëm na nuk kemi dashtë nga buxheti por kemi dashtë me shti operatorin që e ka shkaktuar dëmin që ta rregulloj .

z. Skender Ahmeti; po e nisi pak këtë diskutim me një thënje jo të mirë për deri sa të gjithë asamblistët i bëjnë pyetje qeverisë mbizotëron një heshtje absolute kurse qeveria jep përgjegjeje është një padisiplinë enorme prandaj për mua kryesues niveli i deritashëm i klimës në seancë ka qenë i pa përshtatshëm dhe i pa arsyeshëm, pyetja ka qenë nga Nuredini i cili ka pyetur për shkeljen e të drejtave të punëtorëve për biznese një pyetje shumë e arsyeshme dhe një pyetje që ka bazë se me një far mënyre punëtorët nëpër biznese private po keqpërdoren në aspektin e të drejtave të punës por fatkeqësisht komuna nuk ka inspektor të dikasterit të tyre ne kemi shumë ankesa që punojnë në sektorë private fal zotit kryeministri i tashëm i të gjithë neve ka ardhur me një propozim që ti zgjedh 400 inspektor të punës, znj. Gjylë ka pyetur për mallrat të cilat janë asgjësuar në vitin e kaluar është një sasi e madhe e mallrave ushqimore që kemi asgjësuar janë diku 28 ton ka qenë edhe në informatën e kryetarit të komunës ka qenë ushqimi me origjinë bimore dhe shtazore ka qenë llojllojshmëri e shumë ushqimeve këtë e kemi bërë edhe në bashkëpunim me inspektorët e agjencionit të ushqimit dhe veterinës ushqimet që kemi mund ti asgjësojmë këtu në komunën e Vitisë i kemi bërë këtu ndërsa ushqimet që kanë pas rrezikshmëri ma të lartë i kemi asgjësuar me kompani të licencuar për këtë qështje , qështja tjetër qfar ka rekomanduar inspektorati për çështjen e ujerave të cilat ka ndalur me analiza jo mirë të bërë nga qendra rajonale e shëndetit publik në Gjilan ne i kemi rekomanduar drejtorinë e Arsimit që të merr masa për këtë qështje dhe kanë marr masa ne pardje kemi pasur një atakim në Gjilan tri komunat e anamoravës për çështjen se qfar të ndërmerret për sanimin e ujrave të pijes nëpër shkollat e komunave tona kanë marr masa kanë përdorur filtera kanë përdorur klor në bashkponim me Hidro Moravën , pyetja nga Sejda për pirjen e duhanit është një qështje shumë sfiduese dhe është një qështje

shumë me rëndësi ne kemi filluar në fillim me gjoba kur ka hy në fuqi ligji mirëpo në ndërkohë ligji për kundërvajtje ka ndryshuar dhe gjykata po na i kthen lendet mbrapa për shkak se po e shfaq si inkompetenc të tyre këtu është mirë se ministria përkatëse ta nxjerr një udhëzim administrativ për aplikimin e gjobave mandatorë.

z. Samet Idrizi: Për drejtorin e financave unë kame pas insistim prej qytetareve këtu në rrugën dëshmoret e kombit dhe Ilmi Demiri a kanë qen në paramas shtyllat elektrike dhe ndriçimi se ndriçimi në rrugën Ilvi Demiri nuk është bë aty janë tri drita që i kanë vendos tre qytetar me para të veta e ne ato janë kanë në pramas e janë pagua e nuk ja bë atë here shume keq.

z. Remzi Salihu: drejtor un nuk mendoj që është bash krejt qashtu , mjetet janë kthye pasi është bërë hetime në kompaninë që e ceka ma herët dhe pse pas dy viteve të kthehen ato pastaj për te përmbaruesi nuk e di a un se thash mirë apo ti nuk e kuptove këtu na dhe shpjegime se qfar bënë përmbaruesi na jemi në dijeni se komuna është në marrëveshje me këtë përmbarues mirëpo unë thash se përmbaruesi privat Kushtrim Musa me vendimin e tij i merr komunës hiq më pak se 48 mijë 235,86 euro jo borgjlive të komunës por prej komunës për kompaninë në fjalë vizual media, ntp floringu g dhe n.t.p viva print, un e di se me 3 mars pikërisht është seanca e radhës për lenden për ylli dekor dhe komunën nëse jeni në dijeni drejtor ju po thuani që nuk është e vërtet po un po ju tregoj kur e keni seancën e radhës.

z. Ibrahim Rama; ndoshta u keqkuptuam në lidhje me përmbaruesin privat se na e kemi një marrëveshje me të për obligimet e komunës së Vitisë është fjala aty jemi në rregull se komuna nuk paguan asnjë kompensim për punën që e kryen përmbaruesi atë e paguan obliguesi i borxhit

z. Ekrem Abazi: për nënkryetarin tërthorazi tha që ne nuk keqpërdoremi unë Hasan Aliu e di emrin tënd edhe guxoj nëse ti keqpërdor me ta përmend edhe emrin se kujt si kam obligim edhe kur nuk i ke askujt obligim guxon edhe emra me përmend edhe ty ta kisha përmend emrin që ti je që e keq përdor buxhetin e komunës po nuk je për opozitën sidomos për PDK-në dhe VV-në un mendova se ju do ti arsyetoni ato që i keni shkruar ju dilni keto edhe prezantoni ato keqpërdorime që po thuani kinse janë bërë mua më bëtë me dyshuar se këto nuk janë të vërteta .

z. Bekim Azizi; ne jemi të përgjegjshëm të gjitha shkrimet që i kemi bërë edhe në media që i kemi qit edhe këtu i kemi ngrit Ekrem në seancën e fundit me dokumente kemi paraqitur kontrata që i kanë nënshkruar komuna , çdo kontratë që është e paraqitur është prej dosjeve të tenderëve dhe pagesave që janë bërë nga komuna , 400 mijë euro janë 280 stuba 50 me 50 edhe 80 cm janë lart e qka ka e qka kemi merr qit hala ke me u tmerruar

z. Ibrahim Rama: keni të drejtë në qdo shqetësim që e shini që gjatë aktivitetit të juaj në tërë territorin e komunës un po ju them që qdo shënim që është në kuadër të kësaj drejtorie do ta keni në [kohën e caktuar në qoft se e kërkon veq po apeloj se un kam kërkuar nga zyra ligjore me ja përgadit një dokument po sot ishte e nxanun për do shënime që po bëhen përmes fCB-së na jemi të obliguar me ju dhanë qdo shënim që kërkon zyrtarisht por me i qit në fejsbuk nuk është e lejuar me ligj un po apeloj në kuptimin shoqëror që shënimet ashtu nuk banë me dal

znj: Mirlinda Sadiku; drejtor nuk është që i ke të gjitha informacionet të kujtohet shumë mirë rruga e Tërpezës është harrnuar brenda një jave , e dyta shumë mirë ta tha kolegu Remzi ta tregoj edhe datën e seancës a ju nuk ishit në dijeni për seancë gjyqësore për sa kemi na të drejto kemi të drejtë se na mënyrën qysh zgjedhim me komunikim me publikun është qështje e subjektit tonë politik çdo gjë që e publikojmë është përgjegjësi e jona por asnjë herë pa argument

z. Ramadan Deliu: ju thuani ja rrena ja gënjeshtro ju në vitin e kaluar keni dal keni thanë vet nga VV-ja se keni investuar kryetari 50 milion euro edhe ajo nuk është gabim teknik por rren teknike edhe nuk keni dal me kërkuar falje pas një jave keni shkruar ne fejsbuk kishe gabim , del PDK-ja me një video gjaja se paskan mbetur fshatrat pa rrymë në atë video e kan shikuar 46 mijë vet veq 6 like i keni marr dmth nuk ju ka besuar askush as njerëzit e juaj, prej Kabashit për viti të ka mbytur pluri tash shkoni shikone në Gushicë i ka asfaltuar gjitha rrugët e fshatit edhe qdo fshat është i shtruar me asfalt mua më kish ardhë turp për këto që po i thuani

znj:Liridona Bislimi: i nderuar prej fjalorit tand vetëm 20% munda me të kuptua edhe atë qa mujta me të kuptua po tu përgjigjem, e ke fjalën për T7 kur kam qen nuk e di a din me lexuar shqip e kam shkruar që e kam ngatërruar numrin nëse je tu pak ti në një punë para një viti për një fjalë na po flasim për punët që janë para një muaji nuk po jepni përgjigje ti po më thua mua para një viti e kemi shpjegu e kemi sqaruar se ka qenë gabim teknik në emision

z.Jakup Demiri; e kam një vërejtje ka këtu asamblist që as materialin me vete se marrin nuk e di a e lexojnë a hiq dalin bëjnë replika e mbrojnë kryetarin a nuk e kryen punën e vet ,kryesues edhe një vërejtje ty po ta jap për deri sa foli i nderuari nuk i the hiq krye ma shpejt po foli sa dashtë ndërsa të tjerët po ju bënë presion që me krye ma shpejtë .

z. Bekim Azizi; na asnjë shkri, se kemi ba që ska rrym a diçka a që ke vjedh po që i vendos 42 shtylla metalike ka 9 metra në vitin 2017 koordinatori i likeve na e dimë qe sokoli i ka koordinatorin e likeve që i njehin liket mirpo e rëndësishme është se 48 mijë vet e paskan pa dhe ti je i detyruar me qua me mbrojt se je pjesë e 32 mijë eurove që i keni hëngër

z. Ali Bajrami; nuk e pata mendjen me dal me fol por më nxiten parafolësit më vjen shumë keq se edhe para dy veteve e kam përmend të njëjtën gjë jemi asamblist që kemi ardhur me votën e qytetareve është kualifikim shumë i rënd edhe i pa vend me u marr me kualifikime kush lexon kush nuk lexon kush përcjell kush nuk përcjell ne këtu kemi ardhur se na kanë besuar qytetaret prandaj po e përsëris ta ruajmë nivelin ta ruajmë seriozitetin se jemi përfaqësues të qytetareve të komunës së Vitisë nuk e kisha zgjatë ma shumë.

z.Taulant Haxhiu; un të kisha ftuar me ardh në zyre tonë se Halimi është plakur mu bë administrator mi shikua sa llajka i kemi na nuk është përgjegjësi e jotja me na i shikuar neve llajkat e dyta kryetarin e komunës na e njohim se na jemi pjesë e opozitës kemi drejtë me kritikuar , zotëri Ramiqi të gjitha renovimet që janë bërë që ju ke bërë pranim teknik un në seancën tjetër i pres të gjitha pagesat që i ka bërë drejtorja e financave në krye me Ibrahim Ramiqi

Nënkryetari z. Hasan Aliu: kryesues po të shumë herë që pozicioni i ekzekutivit ma i rënd por kur po të shoh ty në seancë i yti po del ma i vështirë por megjithatë jemi shok duhet ta ruajmë një kodeks është e vërtet se here pas here na ikin se nuk ka njeri të përkryer por megjithatë duhet ruajmë se jeta vazhdon pavarësisht pozicioneve ku jemi në pozitë apo në opozitë un e kam përjetuar edhe rastin e juaj gjashtë vite jam munduar shumë me u kursyer un si besaj as llajkave as asgjë tjetër un i besoj votës së qytetareve momentalisht i ka 11 mijë e 300 vota dhe e kanë zgjedhur qytetaret edhe duhet ta respektoni , sa i përket gjykatës se tha të jeni të bindur se nuk kemi asnjë informatë që dikush do të shkoj në gjykatë me 3 mars , un po e përfundoj me një anekdotë gjatë kohës së rrugëtimit njani e paska pas një rroktar një herë dhe ati i ngordhi një pelë dhe e largoj ky prej pune dhe ndërkohë ,as 10 muajve u takuan në rrugë po ju drejtohet gazdë a e ke pelën që të ka cof po pse po me pyet ti po e din, edh eun po them e kemi diskutu këtë tem, nuk kemi nevojë me u kthye mbrapa ma .

Kryesuesi z. Naim Pira: I falënderoj të gjithë. Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, për mbledhjen e parë të Kuvendit Komunal kemi parapare këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pare e KK-së.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungun e Bungbutës (*quercus pubescens*) në Zhiti të Vitisë, si monument i natyrës.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: burimi i ujit termomineral në Ballancë të Vitisë si monument i natyrës.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungjet e Qarrit (*quercus cerris*) në Binçë të Vitisë, si monument i natyrës.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungun e Qarrit (*quercus cerris*) në Gërmovë të Vitisë si monument i natyrës.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Pylli i Mllakes (*quercus sp.*) në Sllatinë të Epërme të Vitisë, si monument i natyrës.
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Kompleksi i Trungjeve të Dushkut (*quercus sp.*) në Sllatinë të Poshtme të Vitisë, si monument i natyrës.

8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Guri i Blinave në Gjylekar të Vitisë si monument i natyrës
9. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për krijimin e qasjes së parcelës nr. 3760-0 në rrugën publike me nr.2592-11 përmes parcelave me nr.2586-6 dhe nr.2582-8.
10. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e planit te punës se komitetit për komunitete për vitin 2020.
11. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e planit te punës se komitetit për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje për vitin 2020, dhe raporti i punës së këtij komitetit për vitin 2019.
12. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e planit te punës se komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2020.
13. Raport pune nga Zyra e Personelit për periudhën Janar-Dhjetor 2019.

Kryesuesi z. Naim Pira: A ka dikush rrethe rendit të ditës ju lutëm, konstattoj se me vota unanime miratohet rendi i ditës.

Pika e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e KK-së.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat rrethe procesverbalit. A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim? E hedh në votim procesverbalin. Me votat e të gjithëve u miratua procesverbali.

Pika e dytë e rendit të ditës:

2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungun e Bungbutës (*quercus pubescens*) në Zhiti të Vitisë, si monument i natyrës.

z.Ajet Sallahu Drejtor: Përshëndetëj të nderuar të pranishëm, me keto propozime propozohen që të merren në mbroje shtat zona të vlerave natyrore në propozim vendimet që i keni materialin para ju, në vendet dhe monumentet e mbrojtjes së natyrës është trungu i bungëbutës në fsh.Zhiti monument i natyrës së karakterit botanik me sipërfaqe prej 5 ari, pastaj është burimi i ujit termo mineral në fsh.Ballancë si monument i natyrës së karakterit hidrologjik me rreze 10 metra, trungut e qarrit në fsh.Binqe si monument i natyrës së karakterit botanik me sipërfaqe 13 e 97 ari, trungu i qarrit në fsh.Germove si monument i natyrës së karakterit botanik 5 ari me sipërfaqe, pylli i rrënjes në fsh.Sllatin e Eperme si monument i natyrës së karakterit boranik me sipërfaqe prej 13.70 ari, kompleksi i trungjeve të Dushkur në fsh.Sllatin e Poshtme si monument i natyrës i karakterit botanik me 2 hektar, dhe guri i blinave në fsh Gjylekar si monument i natyrës së karakterit gjeomorfologjike që përfshin prej 20 ari, materialin e keni para ju për pyetje jemi në dispozicionin e juaj.

Kryesiesi z.Naim Pira: Hapo debat rreth pikave të propozuara nga drejtori.

z.Samet Idrizi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit unë kame një pyetje per mbrojtjen e këtyre pasurive natyrore të komunes së Vitise kjo është pyetja a do të kete dikune dikune edhe intervenim fizik a po do të mbrohen me ndonjë vendim tjetër.

z.Alban Sokoli zyrtar nga drejtoria e Urbanizmit: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, në pyetjen e parashtruar se a do të ketë intervenime fizike me rrethoja a po i kemi në nenin 4 të propozim vendimit janë të specifikuar qart se qfar veprime duhet të ndërmerren, ku thuhet se kjo sipërfaqe e cila shpallet si zone e mbrojtur pershkak të vlerave natyrore nuk nënkupton që kan me shpronesu dikan prej pronesis a po forma tjera të shpronësimit por ajo sipërfaqe është si zone mbrojtëse ku i ndërmarrim disa veprime që i keni në nenin 4 të proprzim vendimit ku është i garantuar edhe servituti për qasje per ato vlera si dhe jane të garantuara edhe qasje tjera per vizita të interesuar të ndryshëm.

z.Nuredin Lutfoi: Te propozimi i parë dhe propozimi i fundit në fshatin Skifteraj është e njëjta ndërhyrja në burimet rreth ti ketu duhet të ndryshohet sepse nuk ka burim në fshatin Skifteraj propozimi i fundit.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka të tjer per diskutim po e qes në votim per miratim nga të gjithë të pranishmit miratohen kjo pike e rendit të dites.

Si pike të tret të rendit të dites kemi.

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: burimi i ujit termomineral në Ballancë të Vitisë si monument i natyrës.

Kryesuesi z.Naim Pira: Qes në votim per miratim nga të gjith të pranishmit u miratu kjo pike e rendit të dites.

Si pike të katër të rendit të dites

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungjet e Qarrit (*quercus cerris*) në Binçë të Vitisë, si monument i natyrës.

Kryesuesi z.Naim Pira: Qes në votim per miratim nga të gjith të pranishmit u miratu kjo pike e rendit të dites.

Si pike të peste të rendit të dites kemi.

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Trungun e Qarrit (*quercus cerris*) në Gërmovë të Vitisë si monument i natyrës.

Kryesuesi z.Naim Pira: Qes në votim per miratim nga të gjith të pranishmit u miratu kjo pike e rendit të dites.

Si pike të gjatë të rendit të dites kemi

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Pylli i Mllakes (*quercus sp.*) në Sllatinë të Epërme të Vitisë, si monument i natyrës.

Kryesuesi z.Naim Pira: Qes në votim per miratim nga të gjith të pranishmit u miratu kjo pike e rendit të dites.

Si pike të shtat të rendit të dites kemi

7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Kompleksi i Trungjeve të Dushkut (*quercus sp.*) në Sllatinë të Poshtme të Vitisë, si monument i natyrës

Kryesuesi z.Naim Pira: Qes në votim per miratim nga të gjith të pranishmit u miratu kjo pike e rendit të dites.

Si pike të tetë të rendit të dites kemi

8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbrojtjen e vlerës së natyrës: Guri i Blinave në Gjylekar të Vitisë si monument i natyrës

Kryesuesi z.Naim Pira: Qes në votim per miratim nga të gjith të pranishmit u miratu kjo pike e rendit të dites.

Si pike të nente të rendit të dites kemi

9. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për krijimin e qasjes së parcelës nr. 3760-0 në rrugën publike me nr.2592-11 përmes parcelave me nr.2586-6 dhe nr.2582-8.

Drejtori z.Ajet Sallahu: Ky vendim ka qen me parë në kuvend mire po nga Ministria na kan kërku që të kemi mbeshtetje ligjore që të bazohemi edhe në planet hapësinore që ekzistojn në Viti në kete rast ne jemi bazu edhe në planin zhvillimore komunal të Vitise dhe të Kllokotit me nr 01-013/126 të datës 7.2.2011, propozimin e keni marr me kohë per pyetje jame në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat per kete pike.

Nijazi Isaku: Nese me heret e kemi votu kete propozim vendim si që e shpjegoj kryesuesi e ku MAPL e ka kthy prap po nese eshte rruga publike at her pse duhet na me ju dhën qasje ketyre parcelave cili është aspekti ligjore një arsytim pse tash me nxerr ne një vendim kur nësë eshte rruga publike keta kan të drejt qasje në ato prona e tash cila eshte arsya ligjore pse duhet me nxerr kete vendim ne.

z. Ajet Sallahu Drejtor: Ështe problem të blloku I ndertesave të vjetra e që ekziston një rruge edhe ka ekzistu kjo rruge per qasje në parcelen 3760-0 mire po nuk eshte e ndame në kataster si rruge dhe konsiderohet si prone komunale prandaj edhe dy parcela të vogla e kemi pas skicen edhe me heret jan dy parcela shume të vogla që bëhën bashk ato parcela edhe parces 3760 I krijohet një qasje në rrugen Adem Jashari destinimi I kesaj rruge behet në rrug publike ka qen rruge faktike kurse tash bëhët juridikisht.

z.Ali Bajrami: Këtë propozim vedenimi ne si grup parlamentar e mbeshtesim dhe jemi pro ketoj propozim vendimi.

z.Samet Idrizi: Me sa e di une ajo tash e lun rolin e rruges publike aty ka dy tri prona edhe një shtepi keshtu që është mir tash nese votohet kjo me ja dhën një arsyshëmri të mir ligjore që mos mu kthy prap kjo.

Kryesuesi z.Naim Pira: Qes në votim per miratim nga të gjith të pranishmit u miratu kjo pike e rendit të dites.
Si pike të dhjet të rendit të dites kemi

10. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e planit te punës se komitetit për komunitete për vitin 2020.

Ne si kuvend komunal në fillim të mandatit e kemi themelu kete komitet dhe sot para neve e kan sjell planin e punes per vitin 2020 matriali e keni marr me kohe nese ka per diskutim urdheroni, pasi që nuk ka per diskutim qes në votim per miratim, nga të gjith të pranishmit u miratu edhe kjo pik e rendit të dites.

Si pike të njëmbdhjet të rendit të dites kemi.

11. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e planit te punës se komitetit për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje për vitin 2020, dhe raporti i punës së këtij komitetit për vitin 2019.

Edhe ky komitet naj ka sjell planin e punes per vitin 2020 dhe raportin e punes për vitin 2019, matrialin e keni marr me kohe nese ka per diskutim hapi debat, pasi që nuk pat për diskutim qes në votim per miratim nga të gjith të pranishmit u miratu edhe kjo pik e rendit të dites.

Si pike të dymedhjet të rendit të dites kemi

12. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e planit te punës se komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2020.

z.Basri Sylejmani Kryesuesi I ketij komitetit: Pershendete të nderuar të pranishem, unë te kjo pik e rendit të dites propozij që kjo pik e rendit të dites të terjeket nga rendi I dites pershkak se ne nuk kemi disku asgje per kete pike ta kthejm prap në piken zero që ta mbejm edhe një mbledhje dhe ta shqyrtojm kete, tani po ju njoftoj që ne e kemi bë nje visit në shkollen e Terpezes dhe në Pozharan ku keshilltarja Hidajetja ka kerku se aty nuk ka kushte per mesim ne kemi qen komiteti e kemi vertetu se edhe pastertia edhe nxemja të gjitha sa I perket shkolles jan në nivel me prejashtim per dy drrasa ku ato eliminohen kushte per mesim ka edhe në shkollen e Terpezes dhe në Pozharan dhe besoj që krejt shkollat jan në rregulle.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që je kryesues I ketij komitetit po e qes në votim per miratim që kjo pik të sjellet në seancen e ardheshme kush është që të tërjeket kjo pike me votat unanime u terjek kjo pike nga rendi I dites.

Si pike të tremëdhjet të rendit të dites kemi

13. Raport pune nga Zyra e Personelit për periudhën Janar-Dhjetor 2019.

Zyrtari I zyres së persoanelit e kishte një pune që ishte I obliguar të shkone fjalen e ka nënkryetari.

z.Hasan Aliu nënkryetar: Në informaten e kryetarit e keni pas edhe kete informat se bashku me krey zyret tjera po me gjithat ne trajnimet që I kemi pas kan than që është në mesin e performances të sjellet edhe një informat nga zyra e personelit, matrialin e keni pranuar me kohe per pyetje shtes urdheroni.

Kryesiesu z.Naim Pira: Hapi debat per kete pike të rendit të ditës pasi që nuk ka ate her ju falemenderoj të gjithëve per kontributin që keni dhën mireupafshim në seancen e ardheshme

Mbledhja përfundoi me punë në ora 13:30 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Naim Pira